KOMUNIKATË PËR MEDIA

Rezultatet e Anketës së Përdorimit të Teknologjisë Informative dhe Komunikimit (TIK) në Ekonomitë Familjare 2026


23.10.2026

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) publikon rezultatet e Anketës së Përdorimit të Teknologjisë Informative dhe Komunikimit (TIK) në Ekonomitë Familjare për vitin 2026.

Ekonomive Familjare vazhdojnë të kenë qasje të lartë në TIK

Sipas rezultateve të Anketës TIK në Ekonomitë Familjare përqindja e ekonomive familjare që kanë pasur qasje në internet gjatë vitit 2026 ishte rreth 99,1 %. Ndërkohë që 0,8 % e ekonomive familjare kanë deklaruar se nuk kanë pasur qasje në internet gjatë vitit 2026.


Qasja e ekonomive familjare në TIK, 2026



Grup-moshat që kanë pasur qasje në internet

Grup-mosha me përqindjen më të lartë të qasjes në internet është grup mosha 16-24 vjeç me rreth 19,8%, pasuar nga grup-mosha 25-34 vjeç me 19,5%, ndërkohë me përqindjen më të vogël të qasjes në internet është grup-mosha 65-74 me rreth 10%.


Grup-moshat që kanë pasur qasje në internet



Individët që kanë pasur qasje në internet, sipas gjinisë

Në vitin 2026, sipas të dhënave rezulton se përdorimi i internetit nga meshkujt dominon me 52,4 %, krahasuar me femrat me 47,6 %.


Përdoruesit e internetit sipas gjinisë në %



Përdoruesit e internetit që shfrytëzuan mjetet gjeneruese të inteligjencës artificiale (IA)

Sipas të dhënave të Anketës TIK në Ekonomi Familjare, personat që e përdorën internetin në tre (3) muajt e fundit ishte 98,4 %; ndërkaq 57,4 % e tyre i shfrytëzuan edhe mjetet gjeneruese të Inteligjencës Artificiale (IA) për qëllime të ndryshme private, për shkollim ose profesionale.

Shpërndarja e përdoruesve të Inteligjencës Artificiale (IA) sipas grupmoshave dhe qëllimit të përdorimit në 3 muajt e fundit



Për më shumë informata lidhur me rezultatet e Anketës TIK në Ekonomi Familjare për vitin 2026, vizitoni: https://ask.rks-gov.net/Themes/ITC